



Prishtinë, 28 janar 2011
Kodi i ZRRE-së: V_337_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14.2 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A) për derogim të disa neneve të Licencës për Gjenerim TC Kosova A, TC Kosova B, Shpërndarje dhe Furnizim Publik dhe Furnizim/Tregti me energji elektrike, të datës 31.12.2010,

në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2011, nxori këtë:

VENDIM

I. I LEJOHET KEK Sh.A-së derogimi (sipas Shtojcës së bashkëngjitur), në zbatimin e disa neneve të:

- Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike TC Kosova A
- Licencës për Gjenerim të Energjisë Elektrike TC Kosova B
- Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes
- Licencës për Furnizim Publik me Energji Elektrike dhe
- Licencës për Furnizim/Tregti me Energji Elektrike.

Arsyetim

- ZRRE me datë 31.12.2010 ka pranuar kërkesën e ndërmarrjes KEK Sh. a, e cila ka kërkuar shtyrje afati të disa neneve të licencës për Gjenerim TC Kosova A, TC Kosova B, Shpërndarje, Furnizim Publik, dhe Furnizim/Tregti me energji elektrike.
 - Korporata Energjetike e Kosovës, në pamundësi të përmbushjes së kushteve të Licencave ka kërkuar shtyrje afati të disa Neneve të licencave si në Shtojcë të këtij vendimi.
 - ZRRE ka vlerësuar të gjitha dokumentet e dorëzuara nga ndërmarrja KEK Sh.a dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Të gjitha Nenet dhe dispozitat tjera të licencave të KEK Sh.a-së mbesin në fuqi.
- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

*Bashkëngjitur Shtojca me derogimet (shtyrjet e afatit) e lejuara.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar